



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE E PAJISJEVE MJEKËSORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Data: 31/05/2024]

Drejtuar: [“ADEL CO” sh.p.k., me adresë: Rr. “Myslym Keta”, Ish Rezervat e Shtetit, Ferraj, Tiranë]

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur–Mallra–Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-94529-02-05-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barna, dhe aksesori për shtypjen e tyre” për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj, Procedurë e Hapur–Mallra–Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.16 datë 25.03.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. “ADEL CO” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë | L22117021M
Numri i NIPT-t |
|--|------------------------------|

Vlera: 19,748,000 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e tetë mijë) lekë (pa TVSH).

- | | |
|--|------------------------------|
| 2. “ALBDESIGN PSP” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë | L51819005Q
Numri i NIPT-t |
|--|------------------------------|

Vlera: 19,890,000 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH).

- | | |
|--|------------------------------|
| 3. “Inpress” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë | L52122014L
Numri i NIPT-t |
|--|------------------------------|

Vlera: 21,879,000 (njëzet e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë (pa TVSH).

- | | |
|---|------------------------------|
| 4. “DynamicX Group” sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë | L42306022T
Numri i NIPT-t |
|---|------------------------------|

Vlera: 24,250,000 (njëzet e katër milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH).

5. **“KRISTALINA.KH” sh.p.k.**

Emri i plotë i shoqërisë

K11501002D

Numri i NIPT-t

Vlera: 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë (pa TVSH).

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“DynamicX Group” sh.p.k.**

Emri i plotë i shoqërisë

L42306022T

Numri i NIPT-t

Vlera: 24,250,000 (njëzet e katër milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH).

Arsyet e mëposhtme:

“Oferta juaj refuzohet për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e përcaktuara në DST:

1) Shtojca 7 e DST “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, te “2.Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Për arsye se dokumenti i dorëzuar nga ana juaj:

Vërtetim “Për Xhiron e Tre Viteve të Fundit” lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me Nr.Serial T06747304, datë 31.8.2022 ku raportohet xhiro financiare për vitet 2019-2020-2021, i lëshuar për:

“Pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohej në datën 1 Shtator 2022, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Akademia e Studimeve Albanologjike, me objekt prokurimi “Botime për vitin 2022” me vlerë 7,500,000lekë, me vendndodhje në Tiranë.”- në kundërshtim me kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat e Tenderit për këtë prokurim.

2) Shtojca 7 e DST “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, te “2.Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, gërma b):

“b) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (në rast se nuk është prodhues i mirfilltë) duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga Distributori Zyrtar i Autorizuar nga Prodhuesi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.”-

Për arsye se dokumenti i dorëzuar nga ana juaj:

“Autorizim Furnizuesi” i datës 19.2.2024 i subjektit “ILAR” sh.p.k., i nënshkruar nga z.Illir Lleshi nuk përputhet me të dhënat e deklaruara në autorizim ku thuhet:

“Shoqëria “ILAR” sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë QKB-së me numër unik identifikimi të subjektit J62027009T, e përfaqësuar nga znj.Ariana Zeneli, shtetas shqiptar, identifikuar me nr.personal G55111162F në cilësinë e përfaqësuesit të prodhuesit të pullave me elementë sigurie[...]”-;

Ju nuk keni dorëzuar “Autorizim Prodhuesi/ Distributori Zyrtar i Autorizuar nga Prodhuesi” për aksesoret e tjerë për shtypjen e pullave të barnave (shirita stampimi termik) - në kundërshtim me kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat e Tenderit për këtë prokurim.

3) Shtojca 5 “Specifikimet teknike”: -Mospërputhshmëria e kampinonëve të dorëzuar me specifikimet teknike të kërkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.”

Vlera: 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë (pa TVSH).

Arsyet e mëposhtme:

“Oferta juaj refuzohet për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e përcaktuara në DST si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Ju nuk plotësoni kriterin e kërkuar për dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sipas DST, për arsye se:

1) Kontrata me objekt “Blerje Diploma, Mbajtëse Diplome, Libreza Studenti” me Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me Nr.Prot.2392/10, datë 21.1.2020, e shoqëruar me Vërtetim Nr.Prot.708, datë 10.3.2020, me vlerë të realizuar: 1,936,268 lekë pa TVSH, me afat lëvrimi: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, tejkalon afatin e kërkuar në DST ku përcaktohet: furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” - tejkalon afatin 3 vjeçar.

2) Kontrata me objekt “Blerje Diploma, për studentët për nevoja të Universitetit A.Moisiu” me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, me Nr.Prot.212, datë 30.1.2020, e shoqëruar me Vërtetim Nr.Prot.914, datë 30.7.2020, me vlerë të realizuar: 1,384,695 lekë pa TVSH, tejkalon afatin e kërkuar në DST ku përcaktohet: furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” - tejkalon afatin 3 vjeçar.

3) Faturat tatimore për çdo furnizim të kryer me subjekte private (ku shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë) si vijon:

a) Viti 2021 në total 4(katër) fatura në vlerën totale 2,149,270lekë nga të cilat:

- 1(një) faturë me subjektin “ALGRAFIKA” shpk, Nr.40 datë 1.6.2021 (numër serie 99548015) në vlerën prej 1,700,000lekë pa TVSH;

- 3(tre) fatura me subjektin “GOLBI d.o.o” Mali i Zi: Nr.32, datë 11.3.2021 (numër serie 94916717) në vlerën prej 1000Euro me kurs 123.67lekë/euro =123,670lekë, Nr.64, datë 6.5.2021 (numër serie 94916749) në vlerën prej 1200Euro me kurs 148lekë/euro =177,600lekë, dhe Nr.92 datë 14.6.2021 (numër serie 99548027) në vlerën prej 1000Euro me kurs 148lekë/euro =148,000lekë;

b) Viti 2022 furnizime për subjektin “ALGRAFIKA” shpk, në total 4(katër) fatura në vlerën totale 6,097,135lekë nga të cilat:

- Nr.168, datë 17.8.2022 në vlerën prej 1,249,500lekë pa TVSH;

- Nr.172, datë 31.8.2022 në vlerën prej 297,500lekë pa TVSH;

- Nr.188, datë 28.9.2022 në vlerën prej 2,200,055lekë pa TVSH;

- Nr.189, datë 30.9.2022 në vlerën prej 2,350,080lekë pa TVSH;

Nuk plotëson kriterin e kërkuar për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, sipas DST pasi vlera totale e faturave për vitin 2021-2022 është 8,246,405 lekë pa TVSH. - Faza: Kriter i pergjithshem”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [“ADEL CO” sh.p.k., me adresë: Rr. “Myslym Keta”, Ish Rezervat e Shtetit, Ferraj, Tiranë] se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 19,748,000 (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e tetë mijë) lekë (pa TVSH)/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekëore me adresë: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, email: akbpm@shendetesia.gov.al, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 19,890,000 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.571/2024 datë 27.05.2024

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR/
PERSONI I AUTORIZUAR
SHEF SEKTORI I PAJISJEVE MJEKËSORE
Elvira OSHAFI**